VENDIM
Nr. 20, datë 23.2.2015

PËR REVOKIM TË VENDIMIT TË AMA-S NR. 8, DATË 26.3.2014 "PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN E AMA-S NR. 5, DATË 22.5.2013 "MBI MIRATIMIN E PAGESAVE PËR AUTORIZIM""

Në mbështetje të nenit 19, pika 1, germa "f" dhe nenit 25 të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", nenit 121, pika 1 dhe nenit 124, pika 1 të Kodit të Procedurave Administrative, Autoriteti i Mediave Audiovizive

VENDOSI:

1. Të revokojë vendimin AMA-s nr. 8, datë 26.3.2014 "Për një shtesë në vendimin e AMA-s nr. 5, datë 22.5.2013 "Mbi miratimin e pagesave për autorizim"".

2. Ngarkohet administrata e Autoritetit të Mediave Audiovizive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Gentian Sala